

## EVALDA PACI

**“RECHERCHES SUR LES ANCIENS TEXTES ALBANAIS” NË  
TETËDHJETËVJETORIN E BOTIMIT**

Në tetëdhjetë vjet nga botimi në gjuhën frënge i *Recherches sur les anciens textes albanais* me autor filologun frëng Mario Roques studimet mbi tekstet e vjetra shqipe vijnë ta kenë këtë vepër si burim të rëndësishëm referimi.<sup>1</sup>

Vlerësimi i interesit të studiuesit frëng për tekstet e vjetra shqipe vjen në një moment kur filologjia e teksteve shqipe gjindet akoma në një shkallë konsolidimi si disiplinë studimore:

*Filologjia shqiptare, d.m.th. njohja, leximi dhe interpretimi e përdorimi i teksteve shqipe dorëshkrim ose të shtypuna, përkundrazi është ende në hapat e parë. Duhet me t'ardhë keq: shembëlltyra e gjendjeve gjuhësore të mëparshme, e ngulitun ndër dokumentat e shkruem, ndihmon, sado e papërkryeme, për me e kuptue të folmen e gjallë; piketimi kronologjik i dhanun prej teksteve është, për rindërtimin e zhvillimit historik të një gjuhe, një prijës ose një kontroll; nuk ka kurrfarë të folme kaq të vjetrueme që mos të ketë fitue, prej përdorimit me të shkruem njëfarësoj gjurme të ré për të cilën do t'ishte e pakandshme mos me ja vleftësue zanafillen.*<sup>2</sup>

Trajtohen në këtë vepër të filologut frëng një sërë botimesh e dokumentesh shkrimore të shqipes, duke filluar me Formulën e Pagëzimit<sup>3</sup> për të vijuar me një sërë librash të botuar e të ribotuar. *Recherches sur les anciens*

<sup>1</sup> Shih dhe Roques M., *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe dhe shkrime të tjera*, (perkthye nga frengishtja dhe pajisë me shenjime plotësuese nga W. Kamsi), Botime Françeskane, Shkodër, 2011. Botimi në fjalë jo vetëm sjell në gjuhën shqipe një nga kontributet themelore të këtij studiuesi në lidhje me historinë e teksteve të vjetra shqipe, por dhe evidenton më tej shkrimet e këtij të fundit në lidhje me këto tekste.

<sup>2</sup> Roques M., *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera*, (perkthye nga frengishtja e pajisë me shënime plotësuese nga W.Kamsi), Botime Françeskane, Shkodër, 2011, f. 73.

<sup>3</sup> Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f.7: *Formule de baptême selon le rite romain, 1462.-Manuscrit*. Roques ka kryer një studim në lidhje me këtë dokument të rëndësishëm shkrimor të shqipes të botuar në revistën *Romania*, LII (1926), fq. 162-4; 504-505, shoqëruar nga riprodhime fotografike, fakt që rimerret prej tij pikërisht në hyrje të trajtimit mbi formulën e pagëzimit, së bashku me citime studimesh e trajtesash të tjera nga ana e albanologëve. Për riprodhimin dhe komentimin e këtij shkrimi të Roques shih dhe *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe dhe shkrime të tjera*, (perkthye nga frengishtja dhe pajisë me shenjime plotësuese nga W. Kamsi), Shkodër, 2011, f. 15-19.

*textes albanais* botohet pikërisht kur tashmë ishte rizbuluar *Meshari* i Gjon Buzukut nga Imzot Schirò(1909) dhe pasi Justin Rrota kishte realizuar botime të pjesshme të teksteve të tij në revistën *Hylli i dritës* për t'i bashkuar më tej në një libërth me vlerë që dhe citohet e vlerësohet nga vetë studiuesi Mario Roques në këtë vepër të sipërcituar. Në të njëjtin vit(1932) realizohet gjithnjë nën kujdesin e Mario Roques ribotimi i parë i *Dictionarit latinisht-shqip* të Frang Bardhit me një parathënie të vlefshme në të cilën studiuesi frëng trajton aspekte të rëndësishme që kanë të bëjnë me mjaft probleme: përmbajtja e kësaj vepre, vendi që i takon në korpusin e dokumenteve ekzistuese të historishkrimit të shqipes, jeta dhe vepra e autorit të tij etj.<sup>4</sup>Në të njëjtin vit Gaetano Petrotta boton së dyti në një variant të përmirësuar *Popolo, lingua e letteratura albanese*, vepër në të cilën gjinden të përmbledhura arritjet më të rëndësishme të studimeve shqiptare në fushë të gjuhësisë, letërsisë dhe publicistikës shqiptare.

Mario Roques i ka kushtuar përherë vëmendje inicimit të traditës shkrimore në gjuhën shqipe dhe filologjisë së teksteve shqipe si disiplinë si dhe ka gjurmuar gjendjen e teksteve të vjetra shqipe në mjaft biblioteka evropiane. Një fakt i tillë dëshmohet më së miri në këtë vepër të vitit 1932, ndërsa citohen dhe dokumentohen për autorë më të rëndësishëm të letërsisë së vjetër shqipe një sërë veprash e variantesh të ribotuara të tyre. Ai vlerëson me objektivitetin e duhur rëndësinë që kanë dokumentet arkivore jo vetëm për historishkrimin e shqipes por dhe për historinë e vendit.<sup>5</sup>

Një trajtim i mirëfilltë i detajuar i bëhet në këtë vepër librit të parë në gjuhën shqipe. Duket se autorin e ka tërhequr së tepërmi problematika e një libri acefal me mungesë të dhënash të rëndësishme për një vepër të asaj natyre

<sup>4</sup> Te *Recherches, vep. e cituar*, f.32-33, Roques i ka kushtuar *Dictionarit* të Bardhit një paragraf të shkurtër meqë trajtimin më të thelluar e ka kryer pikërisht në *Hyrjen* përkatëse me të cilën ka pajisur botimin fotomekanik të kësaj vepre leksikografike të cituar më sipër.*Dicionari* i Frang Bardhit ndjek në pikëpamje vijimësie *Fjalorthin* e Mazrrekut, të paraqitur nga Roques si një dorëshkrim (manuscrit, 1632) që përmban leksik etimologjik. Shih përkatësisht Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f. 31:11. Petit lexique étymologique de Pietro Maserech. - Manuscrit, 1632.

<sup>5</sup> Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f. 6: Des recherches commencées depuis plusieurs années m'ont amené à revoir moi-même les textes déjà signalés et permis de découvrir pour certains des éditions ou des exemplaires ignorés; j'ai eu la joie de trouver des textes nouveaux, dont un au moins très considérable; enfin, l'examen de publications historiques trop négligées et une enquête, que j'aurais voulu moins rapide dans les archives de Rome m'ont fourni sur l'activité religieuse en Albanie, au XVII-ème siècle, un ensemble de renseignements propre à jeter quelque lumière sur un moment assez mal connu de l'histoire balkanique.

dhe për faktin se mund të dëshmonte më së miri dhe për marrëdhëniet që mund të kenë ekzistuar mes viseve të afërta gjeografikisht me veriun e Shqipërisë në të cilat dhe ndiqeshin praktika fetare që kërkonin medoemos përdorimin e librave si ai i Buzukut apo i veprave që pasojnë kronologjikisht atë.<sup>6</sup>

Një vështrim aq i vëmendshëm i librit nga ana e autorit sigurisht u shërben sqarimit të mjaft çështjeve themelore, përfshirë dhe vendin e mundshëm ku vepra duhet të jetë shtypur.<sup>7</sup> Trajtesa mbi *Mesharin* nuk është thjesht deskriptive. Roques ka analizuar me hollësi shenjat grafike që gjenden në tekstet e librit duke dhënë njëkohësisht dhe burime të tjera pak a shumë të afërta në kohë në të cilat ato janë të pranishme.<sup>8</sup>

Gjithë seria e detajeve të dhëna mbi aspekte kryesisht grafike por dhe të mënyrës së numërimit të faqeve në lidhje me *Mesharin* dëshmon jo vetëm se autori e ka studiuar me vëmendje librin në fjalë, por dhe se ishte i ndërgjegjshëm për rëndësinë e madhe që ai kishte duke qenë ndër librat e parë të plotë në historinë e shkrimit në gjuhën shqipe. Një çështje mjaft e rëndësishme e ngritur nga Mario Roques është dhe ajo e qasjes me modele të ngjashme në viset e Bosnias e Dalmacisë, duke bërë të shprehen qartë deduksione mbi informimin e Gjon Buzukut në lidhje me librat fetarë të përdorur në ato vende.<sup>9</sup>

<sup>6</sup> Një fakt i tillë rimerret gjerësisht nga E. Çabej në trajtimet e tij mbi historinë e gjuhës së shkruar shqipe. Shih Çabej E., *Shqipja në kapërcyell-epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, botime Çabej, Tiranë, 2006, f. 25-26.

<sup>7</sup> Mbi një interpretim të këtij argumenti nisur dhe nga gjykimi i Mario Roques shih dhe Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Roma, 1960, *Introduzione*, f. 8-9.

<sup>8</sup> Sigurisht që një analizë e tillë grafike ndërmerret dhe më parë nga studiues të albanologjisë që i kushtojnë librit në fjalë vëmendjen e merituar. Ato vlerësohen nga Jokli dhe Rrota. Shkrimi i Norbert Joklit (H. D., n.3, 1930) përmban analiza të hollësishme të karaktereve grafike të gjendura në librin e Buzukut. Autori gjykon dhe për përgjegjësit e tyre në fjalët në të cilat ato përmbahen. Në lidhje me identifikimin e shenjave cirilike në alfabetin e përdorur nga Buzuku, interpretimi përkatës është pak a shumë i përafërt me atë të dhënë nga Mario Roques. Jokli i cilëson veçoritë grafike të Buzukut të një rëndësie të veçantë për gjuhësinë dhe kritikën historike të librit. Për më tepër shih pikërisht *Hylli i dritës*, n. 3, 1930, f. 152.

<sup>9</sup> Për një krahasim të mundshëm me libra të ngjashëm me atë të Buzukut të konsultuar dhe prej vetë studiuesit shih pikërisht Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f. 14-15: *Le contenu même de ce petit livre est intéressant a rapprocher du livre de Gjon: il comprend, comme se dernier, l'Office de la Vierge, les Sept psaumes pénitenciaux, les Litanies des saints et de plus, l'Office des morts, c'est-à-dire les éléments constitutifs du livre d'heures. Ne peut-on pas penser que c'est un recueil analogue que Gjon Buzuk a voulu donner aux Albanais dans la première partie de son livre?*

Ideja e ndikimit të Gjon Buzukut nga tekstet e sipërcituara mbështetet nga Mario Roques edhe pas analizash të detajuara të modeleve të njohura nga ana e tij e që datojnë afërsisht me periudhën kur mendohet të jetë shkruar libri i parë në gjuhën shqipe:

*Kështu kjo na shtyn me mendue se Gjon Buzuku u detyron sllavëve katolikë romakë të Bosnjes, të Dalmacisë ose të Serbisë, jo vetëm disa shkronja grafike, jo vetëm t'i jetë sjellë, drejtpërsëdrejti ose jo, shtypshkrojës venedikase, por ndoshta edhe idenë me u dhanë bashkatdhetarëve një libër orësh të hartuem në gjuhën e tyre kombtare. Kjo nuk do t'ishte pa randësi për historinë e përdorimit liturgjik të gjuhëve kombtare në Kishën katolike.<sup>10</sup>*

Roques ka kryer dhe studime të vëmendshme të disa teksteve themelore që përmbahen në librin e Buzukut. Litanitë e Shenjtërve studiohen nga ana e tij në mënyrë që të gjindet a të deduktohet një model i ngjashëm mbi të cilin ai duhet të jetë bazuar. Ky variant i Litanive të Shenjtërve ka tërhequr dhe më vonë vëmendjen e studiuesve të këtij libri,<sup>11</sup> duke mbetur akoma i pasqaruar sqarimi i një varianti apo i disa varianteve gjegjëse që mund t'i kenë shërbyer atij gjatë përpilimit të veprës, përbërja e të cilit mbetet e veçantë dhe sipas vetë Mario Roques qoftë nëse krahasohet me atë të autorëve pasardhës të tij (Budi, Bogdani), por dhe në pikëpamje të vetë kombinimit të elementeve që gjinden në të: pjesë nga Oficja, elemente katekistike, psalme dhe letani, pjesë nga Meshari roman etj.<sup>12</sup>

Në vijimësi në veprën e Roques trajtohet *E mbsuame e krështerë* e Luka Matrangës. Një fakt i tillë ndeshet dhe në botime të tjera të kohës: te Petrotta (1931, 1932) por dhe më tej te *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe* të E. Çabejt (1936).<sup>13</sup> Gjuha e Matrangës bën që autori të japë dhe në fund të përmbledhjes së tij një konsideratë të përgjithshme mbi përkatësinë

<sup>10</sup> Roques M., *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera, (perkthye nga frengishtja e pajisë me shënime plotësuese nga W.Kamsi)*, Botime Françeskane, Shkodër, 2011, f. 37.

<sup>11</sup> Matzinger J., *L'ordine dei nomi dei santi nella litania di Ognissanti nel Manuale pastorale ("Messale") di Gjon Buzuku*, në *Hylli i dritës*, n. 4, 2010, f. 54-73.

<sup>12</sup> Roques M., *vep. e cit.*, f. 16: *D'autre part la composition du livre de Gjon est assez surprenante: les premiers éléments, Petit Office de la Vierge, Psaumes pénitentiels, Litanies, Suffrages, sont, nous l'avons vu les éléments primaires du livre d'heures; la fin, qui est aussi la partie la plus considérable (pres de trois quarts de l'ensemble) est un missel; entre les deux, des elements de cathéchisme et de rituel.*

<sup>13</sup> Të vihet re në këtë botim të E.Çabejt renditja e veprës së Matrangës pas librit të Buzukut, qoftë në përshkrimet teorike mbi autorët, qoftë në studimet e tekstit në rubrikat përkatëse të punimit të cituar.

dialektore të saj dhe vendin që i takon kësaj vepre në historinë e shkrimit shqip, duke qenë një vepër e realizuar në viset arbëreshe.<sup>14</sup>

Në lidhje me këtë studiues, duhet vënë re se çdo trajtesë e bërë mbi veprat e renditura në gjurmimet e tij mbi tekstet e vjetra shqipe mbart veçanti dhe detaje të papërsëritshme, që lidhen me vetë natyrën e secilës prej këtyre veprave. Studiuesi sigurisht nuk ka munguar të sjellë hollësi dhe të pamjeve të para të veprave, frontespiceve përkatëse, lëshimit të lejeve të botimit me detajet përkatëse si dhe me shtojcat apo ribotimet pasuese. Kjo gjë e vënë në dukje sërish nuk e bën thjesht deskriptive ndërmarrjen e tij ndaj gjurmimit të teksteve të vjetra shqipe.

Në veçanti në drejtim të trajtimit të veprës (përkthimeve-përshtatjeve) të Pjetër Budit, interpretimi i gjendjes së veprave të këtij të fundit në bibliotekën e Vatikanit dhe në të tjera biblioteka të mundshme, konceptimi që Roques transmeton në lidhje me këto vepra dhe apendikset poetike që përmbahen në to, bën që kontributi i tij në lidhje me krijimtarinë dhe personalitetin e këtij prelati shqiptar të jetë thellësisht origjinal.<sup>15</sup> Vepra dhe veprimtaria e Pjetër Budit shihet se është gjurmuar me vëmendje nga autori, në veçanti në lidhje me domosdoshmërinë e përdorimit të katekizmave dhe librave të tjerë nga kleri shqiptar në atë periudhë.<sup>16</sup> Në vijim të vlerësimeve të

<sup>14</sup> Roques M., *vep. e cituar*, f. 38: *Les documents que j'ai examiné ici sont, sans doute, à l'exception du fragment de l'Ambrosienne (n. 3), d'origine catholique; ils appartiennent presque tous à l'Albanie du Nord et au dialecte guègue; sauf ce n. 3 et le n. 5, le cathéchisme de Matranga, qui est tosqe d'Italie, nous n'avons pas de document tosqe, si le dictionnaire de Nilo Catalano ne représente pas ce auteur aurait pu apprendre du parler de Cimarra.*

<sup>15</sup> Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f. 21: *Catéchisme de Bellarmin traduit par Pietro Budi, suivi de poesies sacrées. Imprimé, Rome, 1618; plusieurs réimpressions.* Shih gjithashtu më tej, *po aty*, f. 23: F. 175-228: *Poesies sacrées en albanais; 19 pièces uniformément en quatrains d'heptasyllabes à rimes alternées, dont l'ensemble (plus de 2.800 vers) constitue, comme l'a justement indiqué Gius. Schirò, une œuvre poétique digne de considération.*

<sup>16</sup> Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f. 28: *Ce sont en effet ces ouvrages de Budi qui pendant longtemps serviront à l'éducation du clergé albanais. En 1636, le P. Cherubino da Vallebona, franciscain, missionnaire en Albanie, ayant signalé à l'archevêque d'Antivari, Georgius Blancus (l'oncle de Franciscus Blancus, auteur du *Dictionarium latino-epiroticum*) les abus que causait dans le diocèse l'ignorance du clergé, le prélat décide d'écrire à tous ses prêtres une lettre leur enjoignant "sub pœna suspensionis a divinis, ut præ manibus haberent *Catechismum Albanensem, Rituale et Speculum pœnitentiæ, quorum studii operam navarent*". C'est, on le voit, toute l'œuvre de Budi; et ce sont les mêmes livres dont, bien plus tard, les évêques demanderont l'envoi par la Propagande, en même temps que du Dictionnaire de Blancus, encore que la Congrégation n'ait fait réimprimer sur ses presses que la*

bëra dhe nga studiues të tjerë të kohës, Roques vë në dukje kontributin krijues të Budit:

*A peu près inconnue jusqu'ici, l'œuvre de Budi apporte pour l'étude de l'albanais des matériaux considérables: en ramenant au format petit in-octavo ses diverses publications, c'est plus de 800 pages de traduction ou d'adaptation, une cinquantaine de pages de prose originale, plus de soixante de poésies, qui peuvent nous renseigner sur la langue des Albanais du Nord sous l'influence de la culture latine au premier quart du XVI-ème siècle.*<sup>17</sup>

Në lidhje me veprën e Pjetër Bogdanit Roques citon pikërisht botimin e vitit 1685, duke e paraqitur me titullin *Cuneus prophetarum de Christo Salvatore mundi...* de Pietro Bogdan. -Imprimé, 1685.<sup>18</sup>

Trajtimi që i bëhet veprës në fjalë nuk është i përmasave të paragrafeve të mëparshme kushtuar Buzukut apo Pjetër Budit. Duket se Roques mendonte se në lidhje me këtë vepër dhe veprimtarinë e autorit të saj nevojiteshin konsultime me dokumente arkivore të përmbajtura në Arkivat e Propagandës, fakt të cilin ai e citon në hyrje të këtij trajtimi.<sup>19</sup>

Vepra e Bogdanit emërtohet me versionin e shkurtuar *Cuneus* nga Roques dhe në paragrafin kushtuar përshkrimit të kësombllave ekzistuese në

*Doctrina*; mais peut-être avait-elle racheté les volumes du *Rituel* et du *Speculum* imprimés en 1621 chez Zannetti.

<sup>17</sup> Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f. 29; Shih dhe Fishta F., *Mario Roques për filologjinë, kërkimet arkivale dhe historike të vendit tonë*, në BUSHT, n. 3, Tiranë, 1962.

<sup>18</sup> Shih dhe vërejtjen e bërë po aty (f. 34) nga studiuesi në lidhje me ribotimet e veprës së Bogdanit: Original: sur cet important ouvrage et les deux pseudo-éditions nouvelles, mises en vente en 1691 et 1702, sous le titre *L'Infallible verità della Cattolica fede...*, voir É. Legrand, 77, 82 et 85.

<sup>19</sup> Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f. 34. Këtu riprodhohet një dokument i vitit 1675, vit në të cilin mendohet që varianti i parë i veprës së Bogdanit ka qenë i përfunduar nga pikëpamja e këtij të fundit. Bëhet fjalë për një letër drejtuar Propagandës nga vetë Bogdani dhe në të cilën ai e citon veprën e tij me një tjetër titull: *Flauissae prophetarum de Aduentu Messiae epirotice congestae ubi de vita et ejus legitima potestate soli Petri tradita abunde consulitur*. 10 vjet më vonë do të realizohej një ribërje të veprës në një variant dygjuhësh e që në ditët tona njihet nën titullin *Cuneus prophetarum* (*Çeta e profetëve*). Në lidhje me këtë të fundit dhe Roques ka cituar (po aty, f. 35) përgjigjen e Kongregatës në gjuhën latine, në të cilën shihet qartë se kërkohej që vepra të përkthehej: La Congrégation repond: "*Compositio de qua fit mentio translatetur et postea pro correctione ad Em(um) de Albitiis.*"

Shih për këtë dhe Zamputi I., *Shënime mbi jetën dhe veprën e Pjetër Bogdanit*, BUSHT, n. 3, 1954, f. 47-51.

bibliotekat evropiane të botimeve të saj, përkatësisht të vitit 1685 (Padovë) dhe 1691 (Venecia).

Duhet thënë që qoftë në lidhje me librin e Buzukut, qoftë në lidhje me *Dicionarin latinisht-shqip* të Frang Bardhit Mario Roques ka kryer vëzhgime të hollësishme që i kalojnë përmasat e një përshkrimi të përgjithshëm. Interesi i tij për tekstet e vjetra shqipe, përfshirë këtu veprat e Pjetër Budit bëri që të evidentohen dhe variante të tjera të mundshme të gjendura në biblioteka të Evropës. Në këtë përmbledhje të vyer ai nuk ka lënë jashtë vëmendjes gjendjen e arritjeve në fushë të leksikografisë, qofshin në gjendje dorëshkrimi, qofshin botime të realizuara.<sup>20</sup> Në ditët e sotme mund të konstatohet me kënaqësi një përparim i ndjeshëm në fushë të botimeve të tilla, që u përkasin disa disiplinave të rëndësishme të studimeve albanologjike. Arritjet e shënuara në fushë të studimeve mbi filologjinë shqiptare, vijnë natyrshëm kontributin e këtij studiuesi në lidhje me filologjinë e teksteve shqipe.

### Bibliografi

- BOGDANI, P., *Cuneus prophetarum, botim kritik i përgatitur nga A. Omari*, Tiranë, 2005.
- BUDI, P., *Poezi (1618-1621), (botim kritik përg. nga R. Ismajli)*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- BUDI, P., *Poezi, (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R. Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- CAMAJ, M., *Il « Messale » di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.
- ÇABEJ, E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, n. 2, 1959.
- ÇABEJ, E., *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BUSHSHT, n. 3, 1963.
- ÇABEJ, E., *Shqipja në kapërcyell-Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, botime Çabej, Tiranë, 2006.
- ÇABEJ, E., *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- DEMIRAJ, B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe "doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.

<sup>20</sup> Nga Roques evidentohen një sërë dokumentesh e arritjesh në fushë të leksikografisë dygjuhëshe, përfshirë disa nga viset arbëreshe. Vite më vonë, ndërsa shtron sërish çështjen e rëndësishme që ka për studimet albanologjike gjurmimi filologjik i teksteve të vjetra shqipe dhe botimi i tyre, E. Çabej do të përmendte disa nga këto dorëshkrime, duke vënë në dukje dhe ndonjë arritje që lidhej pikërisht me daljen në dritë të tyre. Shih Çabej E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, n. 2, 1959.

- DEMIRAJ B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R. D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- ELSIE R., *Letërsia shqipe. Një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë, 2006.
- FISHTA F., *Nder gjurmimet e veprimit "De propaganda fide" në Balkan, në Hylli i dritës*, n. 7-8, 1932.
- FISHTA F., *Mario Roques për filologjinë, kërkimet arkivale dhe historike të vendit tonë*, në BUSHT, n. 3, Tiranë, 1962.
- ISMAJLI R., *Tekste të vjetra*, botime Dukagjini, 2000.
- MARQUET O., *Pjetër Bogdani, letra dhe dokumente*, Shkodër, 1997.
- MARLEKAJ L., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo*, Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.
- MATRANGA L., *E mbsuame e krështerë*, (a cura di M.Mandalà), Salvatore Sciascia editore, 2004.
- PACI E., *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare*, në Hylli i dritës, n. 2, 2011.
- PETROTTA G., *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, Palermo, 1932.
- RESSULI N., *I più antichi testi albanesi*, në *Shpirti Shqiptar*, nr.3, 1955.
- RESSULI N., *Il "Messale di Giovanni Buzuku"*, (riproduzione e trascrizione), Biblioteca Apostolica Vaticana, Romë, 1958.
- RESSULI N., *Shkrimtarët shqiptarë, I, (nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë)*, Botime Pakti, Tiranë, 2007.
- RIZA S., *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, botime Toena, Tiranë, 2002.
- RIZA S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004.
- RIZA S., *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2009.
- ROQUES M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Librairie orientaliste P. Geuthner, Paris, 1932.
- ROQUES M., *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera*, (perkthye nga frengishtja e pajisë me shenjime plotësuese nga W. Kamsi), Botime Françeskane, Shkodër, 2011.
- RROTA J., *Per historin e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhesore*, Botime françeskane, Shkodër, 2005.
- SCIAMBRA M., *Bogdanica (studi su Bogdani e l'opera sua), volume II, saggio sul lessico scientifico e culturale del Bogdani*, Casa editrice Pàtron, Bologna, 1965.

### SUMMARY

This paper is dedicated to the eightieth anniversary of edition of the work "Recherches sur les anciens textes albanais" of the french philology

---

Mario Roques. In this anniversary of its edition, this work remains still an important source of referring for philological searchers of albanian old texts.

A number of results in the field of albanian old literature are found in this work in form of manuscripts or printings. In reference with fundamental works of this literature, the author has not realized a simple descriptive work. It's obvious that the author is attracted from the problematic of the first book in albanian language "Meshari i Gjon Buzikut (1555)" and Pjetër Budi's works.

Mario Roques has dedicated a lot of work to Frang Bardhi's thematic "Latin-Albanian Dictionary", which belongs at the same time with "Recherches sur les anciens textes albanais".

